

ÇFARË DUHET TË DIMË
PËR DHUNËN SEKSUALE
DHE ATË ME BAZË
GJINORE



**Ending
Violence
Against
Women**



“Ky publikim është përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me mbështetjen e UNDP Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”, financuar nga Qeveria e Suedisë dhe që zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA”.

Ky publikim u drejtohet të gjithë profesionisteve dhe profesionistëve të cilat/cilët identifikojnë, raportojnë, referojnë dhe trajtojnë deri në riintegrim viktime/të mbijetuara të dhunës seksuale"

Fjalorth i termave:

Dhunë sipas Ligjit 9669/2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar me ligjin 47/2018, neni 3 përkufizohet: “Çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik”.

Viktimë sipas të njëjtit ligj cituar më sipër, përkufizohet “Personi mbi të cilin është ushtruar çdo veprim ose mosveprim i një personi tjetër, që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik”.

Dhunë në familje “Çdo akt i dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake ose midis bashkëshortëve ose partnerëve ose midis ish bashkëshortëve ose ish-partnerëve, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën”. Ligji shqiptar “Për Masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” e përkufizon dhunën si “çdo akt dhune i përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, të përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën” (ndryshuar në vitin 2018). Neni 130/a i Kodit Penal të Shqipërisë e përkufizon dhunën në familje si “rrahja, si edhe çdo vepër tjetër dhune ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cënimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij”.

Dhunë fizike përkufizohet “Përdorimi i forcës fizike kundër dikujt në një mënyrë që lëndon, dëmton, ose e rrezikon atë person. Dhuna fizike përfshin një gamë të gjerë sjelljesh si gërvishtjet, shtyrjet, hedhjet, kapjet me forcë, kafshimet, vënien e duarve në fytyrë, pickimet, shpimet, shkuljet e flokëve, përdredhjet e krahut, shuplakat, shtrëngimin me forcë, goditjet, rrahjet, goditjet me shkelma, djegiet, goditjet me thikë, shtrëngimi i fytyrës/mbytyrjet. Dhuna fizike mund të përfshijë edhe përdorimin e madhësisë trupore dhe të forcës, mjeteve të kufizimit të lirisë dhe/ose armëve nga ana e një personi (p.sh., armë zjarri, thikë apo ndonjë objekt tjetër) për të fituar dhe mbajtur kontrollin mbi një person tjetër”.

Dhunë psikologjike përfshin “Një gamë sjelljesh që kanë për qëllim të kritikojnë, poshtërojnë, mbajnë nën kontroll, izolojnë, trembin shkaktojnë frikë dhe të sulmojnë karakterin e një individi duke shkatërruar kështu ndjenjën e tij të vetë-vlerësimit, vetë-besimit, dhe sigurisë. Fyerjet, poshtërimet, të folurit në një mënyrë që sulmon karakterin e individit, të shkatërruarit e ndjenjës së frikës nëpërmjet kërcënimeve për ta lënduar fizikisht një individ dhe/ose persona të tjerë të afërt me të dhe/ose për të shkatërruar diçka të rëndësishme për të, janë disa prej formave të dhunës verbale, sulmit psikologjik e dhunës emocionale që përfshihen si pjesë e dhunës psikologjike.

Dhunë ekonomike: “Mbajtja nën kontroll e parave nga një individ, pavarësisht nëse janë të fituara apo jo prej tij, ushtrimi i kontrollit dhe monitorimi i veprimit të një individi kundrejt një individi tjetër mbi përdorimin dhe shpërndarjen e parave, përfshirë dhe ato të fituara prej punës së këtij të fundit, shpërdorimi për qëllime të kënaqësive vetjake nga ana e një individi, i parave të domosdoshme për sigurimin e kushteve bazë të jetesës së familjarëve, kërcënimi konstant për ndërprerjen e burimeve ekonomike, detyrimi i një individi për të plotësuar të gjitha nevojat bazë të familjarëve për një periudhë të caktuar (p.sh. mujore), me një kuotë nën minimalen e parave që të nevojiteshin për këtë qëllim, etj”.

Dhunë seksuale: “Çdo akt seksual, përpjekje për të kryer një akt seksual, komente ose seksuale të padëshiruara, ose çdo veprim tjetër kundrejt seksualitetit të një personi duke përdorur shtrëngim, nga cilido person pavarësisht nga marrëdhënia e tyre me viktimën, në çdo mjedis, duke përfshirë por pa u kufizuar në shtëpi dhe punë. Shtrëngimi mund të mbulojë një spektër të tërë të shkallëve të forcës. Përveç forcës fizike, mund të përfshijë kërcënime psikologjike, presion ose kërcënime të tjera - për shembull kërcënimi i dëmit fizik, largimi nga puna ose mos marrja e një pune që kërkohet. Mund të ndodhë edhe kur personi i sulmuar nuk është në gjendje të japë pëlqimin - për shembull, kur është i dehur, drogë, në gjumë ose mendërisht i paaftë për të kuptuar situatën. Dhuna seksuale përfshin përdhunimin, të përkufizuar si shtrëngim fizik ose penetrim duke përdorur shtrëngimin - edhe nëse në masë të vogël - i vulvës ose anusit, duke përdorur një penis, pjesë të tjera të trupit ose një objekt. Përpjekja për ta bërë këtë njihet si tentativë për përdhunim. Përdhunimi i një personi nga dy ose më shumë autorë është i njohur si përdhunim në grup. Dhuna seksuale mund të përfshijë forma të tjera të sulmit mbi një organ seksual, duke përfshirë kontaktet e detyruara midis gojës dhe penisit, vulvës ose anusit. Termat sulm seksual, përdhunim, abuzim seksual dhe dhunë seksuale përdoren shpesh në mënyrë të ndërsjellë”.

Dhunë ndaj grave: “Kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private. Dhuna ndaj grave përfshin lloje të ndryshme të dhunës që pësojnë gratë, të rejtat dhe vajzat, si dhunën në familje, dhunën nga partneri intim, dhunën seksuale nga një person jo-partner intim, ngacmimin seksual, martesën e detyruar, abortin dhe sterilizimin e detyruar, përndjekjen, krimet në emër të nderit, trafikimin dhe praktika të dëmshme si gjymtimi i organeve gjinitale femërore”.

Dhunë me bazë gjinore: “Dhuna që drejtohet ndaj një gruaje për shkak se është grua ose që ndikon tek gratë në mënyrë disproporcionale”. Ajo përbën një shkelje të së drejtës themelore për jetesë, liri, siguri, dinjitet, barazi ndërmjet grave dhe burrave, mosdiskriminim dhe integritet fizik dhe mendor.

Ngacmim seksual: " përkufizohet si: “Çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, jo-verbale ose fizike e një natyre seksuale, me qëllimin ose efektin e shkeljes së dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijohet një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose fyes” Ngacmimi seksual është gjithashtu vepër penale dhe parashikohet në nenin 108/a të Kodit Penal të RSH sipas të cilit: "Kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që cenojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. ".

Përndjekje: si vepër penale, parashikohet në nenin 121/a të Kodit Penal sipas të cilit: “Kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t’i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet. Kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, dënimi rritet me një të tretat e dënimit të dhënë. Kur kjo vepër kryhet ndaj të miturit, gruas shtatzënë ose një personi të pazotë për t’u mbrojtur, si dhe kur kryhet nga një person i maskuar ose shoqërohet me mbajtjen ose me përdorimin e armëve, dënimi rritet deri në një të dytën e dënimit të dhënë”.

Marrëdhënie intime: sipas Ligjit 9669/2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar me ligjin 47/2018, neni 3, përkufizohet si “Marrëdhënia ndërpersonale që përfshin, intimitet fizik ose emocional”


Dhunë nga partneri intim: “Çdo sjellje në një marrëdhënie intime që shkakton lëndim fizik, psikologjik ose seksual të personave në një marrëdhënie, përfshirë veprime të agresionit fizik, detyrimit seksual, abuzimit psikologjik dhe sjelljes së kontrolluar”.

Dhunë në lidhje dashurie: “Modele të sjelljeve abuzive, përfshirë abuzimin emocional, fizik, seksual dhe financiar të përdorura për të ushtruar pushtet dhe kontroll tek partneri në lidhjen dashurore”. Në mënyrë të ngjashme, Instituti European për Barazinë Gjinore e përkufizon dhunën në lidhjen dashurore si “lloji i dhunës nga ana e partnerit intim që ndodh midis dypersonave në një marrëdhënie të ngushtë”.

Sulm Seksual: “Akt seksual me apo pa kontakt fizik, i kryer nga një individ pa pëlqimin e viktimës ose, në disa raste, dhe veçanërisht kur janë të përfshirë fëmijët, përmes manipulimeve emocionale ose shantazhit. Është një veprim që e detyron një person t’u nënshtrohet dëshirave të një personi tjetër përmes shpërdorimit të pushtetit, përdorimit të forcës, detyrimit, ose kërcënimeve. Sulmi seksual shkel të drejtat themelore të viktimës, përfshirë të drejtën për integritet fizik dhe psikologjik dhe sigurinë e personit. “Akt seksual me kontakt fizik” përfshin: përdhunimin/marrëdhënien seksuale me penetrim, përpjekjet për të kryer marrëdhënie seksuale me penetrim/tentativë për përdhunim, prekjen/kontaktin seksual. “Akt seksual pa kontakt fizik”, përfshin: ngacmimin seksual, ekspozimin e detyruar ndaj akteve seksuale (pornografi apo një akt seksual që po kryhet), ekspozimin apo zbulimin e organeve gjinitale, nxitjen e një fëmije të prekë trupin e tij/saj apo të masturbohet, bërja e një regjistrimi vizual të një natyre seksuale të një fëmije.

Abuzim seksual i fëmijëve: Çdo aktivitet seksual midis një fëmije dhe anëtari të ngushtë të familjes (incesti) ose midis një fëmije dhe një të rrituri, apo një fëmije dhe një fëmije më të rritur, jo anëtar familjeje. Ai përfshin si rastet e përdorimit të forcës ose detyrimit, ashtu edhe rastet kur nuk mund të jepet pëlqimi nga viktimja për shkak të moshës së tij/të saj ose të saj.

Shfrytëzim seksual: Çdo abuzim aktual ose përpjekje për abuzim, për qëllime seksuale, nga një pozicion i pafavorshëm, ndryshimi në pushtet, ose besimi, përfshirë por pa u kufizuar tek përfitimi monetar, në mënyrë shoqërore, ose politike, nga shfrytëzimi seksual i tjetrit.



VIKTIMAT E DHUNËS SEKSUALE DUHET TË:

- Trajtohen me dinjitet dhe respekt, përgjatë gjithë kohës së marrjes së shërbimeve. Kujdes i veçantë duhet treguar gjatë ekzaminimit dhe mbledhjes së provave mjeko-ligjore, proces ky që duhet paraprirë dhe shoqëruar me informacionin e nevojshëm;
- Njihen me kuadrin ligjor dhe të drejtat e tyre për të përfituar mbrojtje, trajtim, si dhe për të denoncuar rastin me qëllim që dhunuesi të ndiqet penalisht;
- Kenë të drejtën të zgjedhin shërbimet apo trajtimin që do të marrin, pasi të jenë informuar paraprakisht, si dhe të kenë dhënë pëlqimin e informuar. Përgjatë kësaj përbën detyrimi nga ana e profesionistëve për të denoncuar rastin e dhunës seksuale, sipas legjislacionit në fuqi;
- Trajtohen në privatësi dhe sipas parimeve të respektimit të konfidencialitetit dhe ruajtjes së fshehtësisë së të dhënave, përveç rasteve kur ndarja e tyre ndërmjet profesionistëve apo institucioneve të caktuara, përbën detyrim ligjor;
- Mos diskriminohen
- Informohen mbi shërbimet në dispozicion dhe hapat që do të ndërmerren, në qendrat e specializuara të trajtimit të rasteve të dhunës seksuale, si dhe të referohen për trajtime të mëtejshme afatgjata, në qendra/shërbime mbështetëse të specializuara sipas nevojave që paraqesin.

PROFESIONISTËT E TË GJITHË DISIPLINAVE QË PËRFSHIHEN NË TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS SEKSUALE, DUHET TË SHMANGIN:

- Qëndrimet paragjyquese që i fajësojnë viktimat për dhunën e pësuar;
- Veprimet që i bëjnë ato të ndiehen të pafuqishme apo të ripërjetojnë traumën e dhunës seksuale të pësuar (referim në një institucion pa dhënë shpjegime për shërbimin që do të ofrohet, kryerja e procedurave të ekzaminimit të pashoqëruara me informacionin përkatës mbi këto procedura, kërkesë për të firmosur formularë të caktuar pa dhënë më parë informacionin e duhur mbi përmbajtjen e tyre, etj);
- Komentet që i bëjnë viktimat të ndiehen të turpëruara;
- Diskriminimin e viktimave për shkak të gjinisë, moshës, etnisë, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, etj;
- Trajtimin e njëanshëm dhe përjashtues, ose të pa përshtatur me nevojat emergjente, afatmesme apo afatgjata të viktimave.



MBANI MEND! Asnjë nga viktimat nuk është përgjegjëse për sulmin seksual që i ka ndodhur/ka përjetuar. Megjithatë, disa karakteristika mund ta bëjnë një person më të cenueshëm ndaj sulmit seksual. Këta faktorë individualë risku nuk duhet të shërbejnë për të fajësuar personin e viktimizuar, por për t'u mbajtur në konsideratë nga ana juaj si profesionistë, për të parandaluar sulmin seksual duke ndihmuar personat e targetuar si më në rrezik dhe tek të cilët evidentohen faktorët në fjalë. Përgjegjësia për sulmin seksual është gjithmonë e atij që e kryen (pra e dhunuesit)!

Individët më në rrezik për t'u prekur nga dhuna seksuale janë:

- Gratë kryefamiljare të vetme, përfshirë vajzat-nëna;
- Të rejat dhe gratë, të cilat kanë qenë të keqtrajtuara, të dhunuara seksualisht në fëmijëri, si dhe që mund të jenë përdoruese të alkoolit apo drogës, ose viktimat të veprimtarive të paligjshme si prostitucioni apo trafikimi i qenieve njerëzore;
- Fëmijët, kryesisht fëmijët vajza, të moshës 6 - 17 vjeç (ku nga mosha 6-11 vjeç janë më të rrezikuar nga incesti), të cilët janë jashtë vëmendjes/mbikëqyrjes së prindërve, kanë prindër nën varësi të alkoolit dhe substancave narkotike, ose jetojnë në familje me njerëz;
- Fëmijët nën kujdes alternativ;
- Fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara fizike dhe/ose mendore;
- Fëmijë dhe të rritur përdorues të drogës dhe alkoolit;
- Fëmijë dhe të rritur të cilët kanë përjetuar dhunë dhe abuzim në të kaluarën;
- Fëmijë dhe të rritur në situatë rruge ose/dhe të pastrehë;
- Fëmijë dhe adoleshentë të pashoqëruar;
- Vajzat, të rejat dhe gratë që mbajnë fëmijët e konceptuar nga përdhunimi, si edhe vetë fëmijët e tyre të lindur nga përdhunimi;
- Personat nga komuniteti LBGTI;
- Vajzat dhe gratë nga komuniteti Rom dhe Egjiptianë;
- Gratë e moshuara;
- Gratë, të rejat, vajzat, burrat, të rinjtë dhe djemtë e ndaluar/a, arrestuar/a, në pritje të dënimit apo të dënuar/a.

FAKTORËT QË RRISIN RREZIKUN E TË QENIT VIKTIMË E DHUNËS SEKSUALE

01

Faktorët individualë



- Vetëvlerësim i ulët
- Beson në të gjithë mitet për marrëdhëniet e dhunshme midis burrit dhe gruas
- Beson në vlerat e familjes tradicionale dhe të bashkuar dhe respekton e praktikon rolet gjinore tradicionale,
- Merr përgjegjësi dhe fajëson veten për veprimet e kryera nga dhunuesi,
- Mohon frikën dhe zemërimin që ndjen
- Mban qendrim pasiv
- Shfaq shenja dhe bie në situatë stresi, të shoqëruar me ankesa psiko-fiziologjike
- Përdor marrëdhëniet seksuale për të vendosur marrëdhënie intime,
- Beson se askush nuk mund ta ndihmojë t'i zgjidhë problemet

02

Faktorët ndërpersonalë

- Mjedis familjar i karakterizuar nga dhuna
- Histori të abuzimit fizik, seksual ose emocional
- Mjedis familjar emocionalisht jo-mbështetës
- Marrëdhënie të dobëta prindër-fëmijë
- Përfshirja në një marrëdhënie intime të dhunshme ose abusive fizike dhe konflikti



03

Faktorët komunitarë

- Varfëria
- Mungesa e mundësive për punësim
- Mungesa e mbështetjes institucionale
- Toleranca e përgjithshme ndaj dhunës seksuale, si dhe mungesa e diskutimeve të hapura rreth kësaj forme dhune brenda komunitetit
- Numri i ulët i denoncimeve të rasteve të dhunës seksuale dhe i ndëshkimit të dhunuesve

04

Faktorët shoqërorë

- Normat shoqërore që nxitin/favorizojnë dhunën seksuale
- Normat shoqërore që mbështesin epërsinë dhe të drejtën e burrave për të kryer marrëdhënie seksuale
- Normat shoqërore që ruajnë inferioritetin dhe nënshtrimin seksual të grave
- Mungesa e zbatimit korrekt dhe në kohën e duhur të kuadrit ligjor mbi dhunën ndaj grave e dhunën në familje
- Nivele të larta krimi dhe forma të tjera dhune
- Shoqëria nuk pranon dhunën seksuale në marrëdhëniet martesore dhe nuk flet për të





KARAKTERISTIKAT E INDIVIDËVE MË TË PRIRUR PËR TË KRYER SULM SEKSUAL:

- Aftësi të pakëta/mungesë e aftësive për t'u socializuar
- Ndjesi e mungesës së fuqisë/pushtetit/kontrollit
- Vetëvlerësim i ulët
- Ndjenja poshtërimi
- Probleme të atashimit emocional
- Marrëdhënie jo të kënaqshme me të rriturit
- Cënueshmëri/prbleme lidhur me "burrërinë"
- Vetmi
- Probleme seksuale
- Abuzime me substancat
- Vështirësi për të kontrolluar sjelljet impulsive
- Mungesë e kënaqësisë seksuale (frekuenca, kënaqësia e arritur, etj)
- Arritje e kënaqësisë seksuale si pasojë e vuajtjeve që i shkaktojnë viktimës etj.

FAKTORËT QË RRISIN RREZIKUN QË NJË INDIVID TË KRYEJË SULM SEKSUAL:

01



Faktorët individualë

- Të qenit viktimë e abuzimit fizik apo seksual në fëmijëri
- Të qenit dëshmitar i dhunës në familje në fëmijëri
- Vetëvlerësim i ulët
- Probleme psikologjike (depression, aknith, çrregullim i stresit post-traumatik, etj)
- Personalitet anti-social / mangësi në aftësinë për t'u socializuar
- Abuzim me substancat
- Probleme të sjelljes dhe probleme seksuale
- Çrregullime të personalitetit
- Të besuarit në mitet rreth dhunës seksuale
- Fantazi e shfrenuar seksuale
- Fiksimi pas pornografisë që nxit fantazinë/dëshirën për sulme seksuale

02

Faktorët ndërpersonale

- Mjedis familjar i karakterizuar nga dhuna
- Shoqërimi me persona që kanë kryer krime seksuale
- Probleme me krijimin e marrdhënieve intime
- Izolim social
- Mbështetje e pakët/mungesë mbështetjeje nga familja
- Mjedis familjar patriarkal



03

Faktorët komunitarë

- Mundësi të pakta punësimi
- Toleranca e përgjithshme ndaj dhunës seksuale, si dhe mungesa e diskutimeve të hapura rreth kësaj forme dhune
- Mungesa e mbështetjes institucionale
- Numri i ulët i denoncimeve të rasteve të dhunës seksuale dhe i ndëshkimit të dhunuesve

04

Faktorët shoqërorë

- Normat shoqërore që nxitin/favorizojnë dhunën seksuale
- Normat shoqërore që mbështesin epërsinë dhe të drejtën e burrave për të kryer marrëdhënie seksuale
- Normat shoqërore që ruajnë inferioritetin dhe nënshtrimin seksual të grave
- Mungesa e zbatimit korrekt dhe në kohën e duhur të kuadrit ligjor mbi dhunën ndaj grave e dhunën në familje
- Nivele të larta krimi dhe forma të tjera dhune

DISA SHENJA TË ABUZIMIT SEKSUAL

- Shenja të depresionit, të tilla si trishtim i vazhdueshëm, mungesë energjie, ndryshime në gjumë ose oreks, tërheqje nga aktivitetet normale;
- Simptoma të stresit post traumatik (PTSD);
- Mbyllje në vetvete, mos pasja e dëshirës për t'u kujdesur për veten;
- Sjelljet vetë-dëmtuese, mendimet për vetëvrasje ose sjelljet vetëvrasëse;
- Vetëvlerësim i ulët;
- Infeksione seksualisht të transmetueshme;
- Ankth ose shqetësim për situatat që nuk dukeshin të shkaktonin ankth në të kaluarën;
- Shmangia e situatave ose vendeve të caktuara;
- Rritja e përdorimit të drogës ose alkoolit.



"Mos harroni! Shumë viktime të dhunës seksuale të cilat kanë nevojë për ndihmën e parë psikologjike nuk e pranojnë dhunën e pësuar dhe nuk kërkojnë ndihmë"



Disa nga pasojat e dhunës seksuale

PASOJAT E MENJËHERSHME PSIKOLOGJIKE TEK FËMIJËT E ABUZUAR SEKSUALISHT:

- Të qenit i shokuar
- Frikë
- Ankth, nervozizëm
- Ndjenja faji
- Simptoma të çrregullimit të stresit post-traumatik
- Dëshirë për mohim
- Ngatërrim/mos mbajtje mend e vendeve/ngjarjeve
- Tërheqje, izolim, etj



PASOJA TË MËVONSHME TEK FËMIJËT E ABUZUAR SEKSUALISHT

- Ndryshime neurobiologjike
- Vonesa në zhvillim
- Zemërim, agresivitet
- Probleme të sjelljes seksuale
- Simptoma të çrregullimit të stresit post-traumatik
- Probleme me sjelljen
- Vetëvlersim i ulët
- Simptoma depresioni
- Ankth, frikë, mosbesim tek të tjerët
- Mospërshtatja në shkollë
- Sjellje të izolimit social, etj

PASOJAT E ABUZIMIT SEKSUAL TEK ADOLESHENTËT

- Ndryshime neurobiologjike
- Simptom të depresionit
- Ankth, frikë, mosbesim tek të tjerët
- Simptoma të çrregullimit të stresit post-traumatik
- Vetëvlerësi i ulët dhe imazh negativ për trupin e tyre
- Mendime vetëvrasëse dhe tentativë për vetëvrasje
- Çrregullim të të ngrënit (anoreksi, bulimi)
- Probleme të sjelljes, izolimit social
- Dëshira për të qendruar vetëm në shtëpi apo për t'u larguar nga shtëpia
- Abuzim me alkoolin dhe drogën
- Rrezik për shtatzani të hershme (tek vajzat)
- Marrëdhënie seksuale me shumë partnerë
- Infeksione seksualisht të transmetueshme
- Mungesë kënaqësie në lidhjet intime dhe marrëdhëniet seksuale, etj.

PASOJAT E ABUZIMIT SEKSUAL TEK TË RRITURIT:

DËMTIME NË SHËNDET

- Çrregullime somatike (migrenë, ndjese të fikëti, të përziara..etj.)
- Probleme të ushqyerjes, çrregullim i oreksit
- Sjellje seksuale të rrezikshme (marrëdhënie seksuale të pambrojtura, me shumë partnerë, etj)
- Prani më e shpeshtë në shërbimet e kujdesit shëndetësor
- Dhimbje të barkut dhe çrregullime të ciklit menstrual (tek gratë)
- Rrezik i lartë i infektimit me sëmundje seksualisht të transmetueshme apo me HIV-AIDS

PASOJAT PSIKOLOGJIKE

- Frikë, ankth, çrregullime të marrëdhënieve në shoqëri
- Depression i rëndë
- Çrregullim i stresit post-traumatik
- Mendime vetëvrasëse dhe tentativë për vetëvrasje
- Abuzim me alkool dhe drogë



PASOJAT NË MARRËDHËNIET SHOQËRORE

- Më pak besim/ mungesë besimi tek të tjerët
- Izolim
- Frikë për të ndërtuar një marrëdhënie intime, etj.



Trajtimi i viktimave me shërbime mbështetëse të specializuara e sipas standardeve

Trajnime për ofruesit e shërbimeve

Zbatimi korrekt dhe në kohë i kuadrit ligjor, si dhe përmirësimi i tij

Të parandalojmë dhunën seksuale dhe të mbrojmë viktimat

Programe edukuese dhe informuese mbi format e ndryshme të dhunës dhe mbrojtjen që ofrohet

Fushata ndërgjegjësuere për të luftuar stereotipet gjinore dhe mendësitë patriarkale



Këshilla për profesionistët që punojnë drejtpërdrejt me viktimat e dhunës seksuale:

- Besoni viktimën pa kushte.
- Pranoni atë që dëgjoni pa gjykim.
- Tregojini viktimës se abuzimi nuk ndodhi për fajin e saj/tij.
- Shmangni pyetje të tilla si “Pse ishe në atë zonë në atë kohë”?
- Kuptoni që nuk mund të kontrolloni se si ndiehet viktimja. Është e rëndësishme që të mos supozoni se e dini se si viktimja ndihet - pothuajse çdo reagim nga ana e saj është i mundur dhe plotësisht normal.
- Jini dëgjues të mirë dhe tregohuni të durueshëm.
- Sigurojeni viktimën se ju jeni atje për të kur ajo/ai është gati të flasë.
- Lejojeni të flasë kur dhe nëse viktimja dëshiron të flasë për sulmin seksual.
- Ndihmoheni viktimën të rimarrë kontrollin mbi jetën e saj/tij.
- Mbështesni vendimet dhe zgjedhjet që bën viktimja pa dhënë gjykim. Mundohuni të mos i tregoni viktimës se çfarë të bëjë. Ndihmoheni atë me dhënien e mundësive dhe burimeve që ajo/ai të marrë vendimin e duhur.
- Respektoni nevojën e viktimës për intimitet.
- Nëse viktimja dëshiron të rrijë vetëm, respektojeni atë vendim, por mos e lini atë jashtë vëmendjes.
- Mos sugjeroni që viktimja "të vazhdojë" me jetën e saj/tij dhe të harrojë abuzimin. Viktimja ka nevojë për mundësinë për të punuar mbi traumën dhe për të filluar procesin e shërimit.
- Mos harroni të kujdeseni për veten tuaj dhe të kërkonit mbështetje nëse keni nevojë për të.

Mite dhe fakte rreth abuzimit seksual

Mit

Viktimat provokojnë abuzimin seksual kur vishen në mënyrë provokuese

Fakt

Përdhunimi dhe abuzimi seksual janë krime dhune dhe kontrolli që burojnë nga vendosmëria e një personi për të ushtruar pushtet mbi një tjetër. As veshja dhe as sjellja provokuese nuk janë ftesa për veprime seksuale të padëshiruara.

Mit

Shumica e sulmeve seksuale kryhen nga të huajt

Fakt

Shumica e sulmeve seksuale dhe përdhunimeve kryhen nga dikush që viktimat e njeh.

Mit

Djemtë dhe burrat nuk mund të dhunohen seksualisht

Fakt

Djemtë dhe burrat mund të përdoren ose dhunohen seksualisht.

Mit

Një person nuk mund të dhunojë seksualisht partneren ose bashkëshorten

Fakt

Dhuna seksuale në marrëdhëniet martesore ekziston dhe duhet të denoncohet dhe të trajtohet si dhunë

Mit

Fëmijët që janë viktimat e abuzimit seksual do të vuajnë efektet e kësaj traume për gjithë pjesën tjetër të jetës së tyre

Fakt

Abuzimi seksual mund të ketë pasoja serioze afatshkurtra dhe afatgjata për fëmijët që janë viktimat, por disa kushte, të tilla si mbështetja e familjes dhe miqve, i ndihmojnë viktimat të përballen me pasojat

Mit

Viktimat e abuzimit seksual u përkasin grupeve të caktuara e të pambrojtura të shoqërisë

Fakt

Çdokush mund të jetë viktimë e dhunës seksuale. Njerëzit i përmbahen fort këtij miti sepse ai u ofron atyre një sens të rremë sigurie. E vërteta është, se njerëz të të gjitha moshave, racave, grupeve socio-ekonomike dhe përkatësie fetare kanë qenë viktimë e dhunës seksuale.

Mit

Abuzuesit janë lehtësisht të identifikueshëm nga pamja e tyre fizike, veprimet ose fjalët

Fakt

Nuk ka asnjë profil standard mendor ose fizik që përcakton një abuzues. Një abuzues mund t'i përkasë çdo moshe, race, statusi ekonomik, sistemi besimi ose kulture.

Kontakte të rëndësishme:

Telefononi Policinë e Shtetit në numrin 129

Telefononi në Linjën e Këshillimit për Gra dhe Vajza 116 117

Telefononi Qendrën LILIUM në (+355) 69 30 79 598

Të gjitha viktimat e dhunës seksuale trajtohen tek Qendra e Menaxhimit të Krizës për Rastet e Dhunës Seksuale, LILIUM.

Qendra LILIUM ofron shërbime mjekësore, psikosociale dhe ligjore për viktimat e dhunës seksuale 24 orë në 7 ditë të javës. Shërbimet e ofruara nga kjo qendër janë afatshkurtëra, që do të thotë se shërbimi zgjat nga 24 orë deri në 72 orë. Të gjitha viktimat që e ndjejnë veten të abuzuar seksualisht, pavarësisht moshës, gjinisë, racës, etnisë, besimit fetar, vendbanimit, aftësisë së kufizuar, apo sjelljes seksuale, marrin shërbim të menjëhershëm pranë Qendrës.